



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1437/3 prot

Datë 10.09.2021

**V E N D I M**  
**Nr. 603/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit me Nr. REF-97586-06-07-2021 me objekt “*Loti 12 Mikroskopë*”, me fond limit 18,607,227 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK  
*Adresa: Blv. “Bajram Curri”, Rr. “Nikollë Kaçorri”, Nd1, Tiranë.*

**Autoriteti kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
*Adresa: “Rruga e Dibrës”, Nr. 372, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.06.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-97586-06-07-2021 me objekt “Loti 12 Mikroskopë”, me fond limit 18,607,227 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 14.06.2021 operatori ekonomik “Montal” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK dhe me shkresën nr. 1652/15 prot., datë 24.06.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht ankimuesi në ankesën e paraqitur ka ngritur pretendime mbi specifikimet teknike për artikullin “Mikroskop operator okulistik” dhe artikullin “Mikroskop operator ORL”. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar disa prej pretendimeve si vijon:

*“[...]Lidhur me pretendimin e Oe për ndryshimin e Specifikimit “Me zmadhim të motorizuar të paktën 4X-23X, Ksha vlerëson se specifikimi i kërkuar nga operatori ekonomik “Me zmadhim të motorizuar të paktën 4X-21X”, është një kriter i mjaftueshëm për të realizuar zmadhimin dhe fokusin e nevojshëm dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues ky specifikim ndryshohet si vijon:  
Bëhet: Me zmadhim të motorizuar të paktën 4X-21X.*

*Lidhur me pretendimin e Oe për ndryshimin e Specifikimit “Te jetë me fokus të motorizuar nga +18mm deri në - 32mm” Ksha vlerëson se kërkesa e operatorit ekonomik nuk ndikon si në aspektin mjekësor dhe inxhinierik, ky specifikim i kërkuar nuk ndikon në performancën, si dhe në funksionalitetin e pajisjes, pasi mjafton të plotësohet njëra prej specifikimeve ose tjetra të cilat janë ekuivalente. Sa më sipër, për të qenë më të hapur edhe të qartë për operatorët ekonomike pjesmarrës në këtë lot në këtë specifikim ndryshohet si më poshtë:*

*Bëhet: Të jetë me fokus të motorizuar nga +18mm deri në - 32mm ose Të jetë me fokus të motorizuar prej të paktën 50mm me rikthim automatik.*

*Lidhur me pretendimin e Oe për ndryshimin e specifikimit “Inklinimi i okularve të jetë të paktën 200°*

*Ksha argumenton se në kuadër të nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues, gjithashtu për të garantuar edhe pjesmarrjen e prodhuesve lider botëror në fushën e mikroskopeve, kërkesa e operatorit ekonomik pranohet pjesërisht:*

*Bëhet: Inklinimi i okularve të jetë të pakten 180°*

*Lidhur me pretendimin e Oe për Specifikimin “Okularët të jenë me kënd të gjerë 10X me rregullim të diopter (+5d deri në -8d)*

*Vlera e okularit është e percaktuar në këtë kriter 10x. Sipas KSHA, mikroskopët gjithashtu kanë rregullime dioptri të rregullueshme. Cilësimet e dioptrisë variojnë minimalisht nga -5 në 15 dhe përdoren për të rregulluar akomodimin, e cila është aftësia për të përqendruar lentet e syve. Cilësimet e dioptrisë janë veçanërisht të rëndësishme, në mënyrë që gjithçka të jetë në mënyrë të njëtrajtshme në fokus. Ato rreshtohen manualisht ose me një çelës të vogël derisa të bashkohen dy qarqet divergjente të dritës për të realizuar një fokus të vetëm. Megjithatë rregullimi i dioptrisë për një diapazon korigjimi nga +5 dioptri në -5 dioptri, na jep fokusin e kërkuar, pa ndikuar në performancën, si dhe në funksionalitetin e pajisjes, Rrjedhimisht, në kuadër të nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues, gjithashtu për të garantuar edhe pjesmarrjen e prodhuesve lider botëror në fushën e mikroskopeve, kërkesa e operatorit ekonomik qëndron pjesërisht:*

*Bëhet: Okularët të jenë me kënd të gjerë 10X me rregullim të diopter (minimalisht +5d deri në - 5d)*

*Lidhur me pretendimin e Oe për Specifikimin “Te ketë filter UV të integruar”*

*KSHA vlerëson se kërkesa e operatorit ekonomik nuk ndikon as në aspektin mjekësor dhe inxhinierik, ky specifikim i kërkuar nuk ndikon në performancën, si dhe në funksionalitetin e pajisjes, pasi mjafton të plotësohet njëra prej specifikimeve ose tjetra të cilat janë ekuivalente, filteri UV është një specifikim i domosdoshëm, ai mund të jetë i përfshirë ose i integruar me*

*rregullim automatik të dritës. Sa më sipër për të qenë më të hapur edhe të qartë për operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë lot ky specifikim ndryshohet:*

*Bëhet: Të ketë të përfshirë filtrat blue UV, dritë dite, dritë e lehtë ose të ketë filter UV të integruar.*

*Për sa i përket pretendimit të OE për specifikimin “Të ketë platformë lëvizje X-Y së paku 58mm x 58mm”*

*Nisur nga broshurat e prodhuesve të njohur në këtë fushë, dimensionet standarde dhe me të përdorshme të kësaj platforme janë rreth 50x50mm. Përmasa më të mëdha se këto mund të jenë avantazh por janë kusht skualifikues. Ndërkaq, kthimi i motorizuar në pozicionimin fillestar është që një aftësi që kërkohet nga mjekët për rritjen e saktësisë dhe ergonomisë. Për sa më sipër, specifikimi ndryshon si më poshtë:*

*Bëhet: Te kete platforme levizje te motorizuar X-Y se paku 50mm x 50mm me rikthim automatik”*

*Për pretendimin e OE lidhur me specifikimin “të ketë krah të balancuar për peshën ndihmuar nga sensori”*

*KSHA argumenton se prodhues të ndryshëm kanë mekanizma të ndryshme për balancimin e peshës dhe në këtë mënyrë për rritjen e manovrueshmërisë së pajisjes. Menyra e balancimit te krahut nuk duhet te perbeje kusht skualifikues, ne frymen e LPP dhe RRPP ky specifikim ndryshon si më poshtë:*

*Bëhet: “Të ketë krah të balancuar për peshën”.*

*Lidhur me specifikimin “Mikroskopi duhet të ketë observues stereoskopik me asistentin me inklinim në të 3 akset, okularte me inklinim 150° distancë interpupulare 58-73mm”*

*KSHA, për të mos penguar pjesëmarrjen e produkteve të tjera alternative, duke qenë se për mënyren e pozicionimit diapazoni 59-25° është i mjaftueshëm për të realizuar ndërhyrjet të gjata vlerëson se pretendimi i operatorit qëndron dhe specifikimi ndryshon si më poshtë vijon:*

*Bëhet: Mikroskopi duhet të ketë observues stereoskopik për asistentin me inklinim në të 3 akset, okularët me inklinim minimum 5°-25°, me distancë interpupulare 58-73mm.*

*Për Artikullin 2 të lotit 12*

*Pretendimi i OE për specifikimin “Me zoom të motorizuar të paktën 1.5-14x”*

*Specialitet e fushës vlerësojnë se për këtë kategori mikroskopësh kirurgjikale diapazoni standart është 2X-14X. Kështu për të mundësuar ofrimin e sa më shumë produkteve cilësore duke ruajtur të njëjtin funksionalitet dhe pamje optimale ky specifikim ndryshohet si më poshtë vijon:*

*Bëhet: Me zoom të motorizuar të paktën 2x-14x.*

*- Pretendimi i OE për specifikimin “Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri në +115°, tilt -35 deri +35”*

*KSHA argumenton se prodhuesit e tjerë kryesor kanë kthimet e ngjashme të mjaftueshme për të realizuar ndërhyrjet e gjata me komoditet. Për të mundësuar ofrimimin e sa më shumë produkteve cilësore në këtë garë, duke ruajtur njëjtin funksionalitet dhe pamje optimale, kërkohet që ky specifikim të ndryshohet.*

*Bëhet: Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri në +95°, tilt -45 deri +45*

- Lidhur me specifikimin “Okularët të jenë me kënd të gjerë 10X me rregullim të diopter (+5d deri në -8d)”

Duke qenë se ky specifikim nuk ofron vlera shtesë, grupi i punës mendon se ndryshimi i specifikimit mund të lejojë pjesëmarrjen e prodhuesve të tjerë

Behet: Okularët të jenë me kënd të gjerë 10X me rregullim të diopter (+5d deri në -5d)

Për pretendimin “Të ketë krah të balancuar për peshën të ndihmuar nga sensori”

Prodhues të ndryshëm kanë mekanizma të ndryshme për balancimin e peshës dhe në këtë mënyrë për rritjen e manovrueshmërisë së pajisjes. Mënyra e balancimit të krahut nuk mund të jetë kusht skualifikues.

Lidhur me pretendimin e oe për Specifikimin “Mikroskopi duhet të ketë observues stereoskopik për asistentin me inklinim në të 3 akset, okularët me inklinim me 150° distancë interpupulare 58-73mm

KSHA, për të mos penguar pjesëmarrjen e produkteve të tjera alternative, duke qenë se për mënyrën e pozicionimit diapazoni 5°-25° është i mjaftueshëm për të realizuar ndërhyrjet të gjata vlerëson se pretendimi i operatorit qëndron dhe specifikimi ndryshon si më poshtë vijon:

Behet: Mikroskopi duhet të ketë observues stereoskopik për asistentin me inklinim në të 3 akset, okularët me inklinim minimum 5°-25°, me distancë interpupulare 58-73mm. [...]”

II.4. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 340/2021, datë 05.07.2021 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me Nr. REF-97586-06-07-2021 me objekt “Loti 12 Mikroskopë”, me fond limit 18,607,227 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 01.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik

II.5. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, në mbështetje të nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr.1060/4 prot. datë 08.07.2021 me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP ka njoftuar palët në këtë proces për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 13.07.2021. Komisioni i Prokurimit Publik, ftoi në seancë dëgjimore të gjithë palët në proces, autoritetin kontraktor, ankimuesit, ndërkohë, nga ana e autoritetit kontraktor u kërkua përfaqësimi në dy nivele, specialistë, anëtarë të njësisë së prokurimit, pjesë të procesit të hartimit të specifikimeve teknike si edhe ka kërkuar pjesëmarrjen e një specialisti/ eksperti sipas fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk është përfshirë në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit.

II.6. Në datën 13.07.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis operatorit ekonomik ankimues, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore, Komisioni drejtoi pyetje specialistëve të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues, me

qëllim shqyrtimin e pretendimeve të palëve dhe verifikimin e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor. Gjatë seancës, u mbajt Procesverbali datë 13.07.2021, i cili u nënshkrua nga të gjitha palët pjesëmarrëse në seancë. Në seancën dëgjimore, nga ana e autoritetit kontraktor u paraqitën vetëm specialistë të fushës, pjesë të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga palët në seancën dëgjimore të datës 13.07.2021, me anë të vendimit nr. 377/2021, datë 16.07.2021, për pjesën ankesës të papranuar nga autoriteti kontraktor, vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-97586-06-07-2021 me objekt “Loti 12 Mikroskopë”, me fond limit 18,607,227 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 01.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve duke përfshirë edhe ndryshimet e kryera nga KSHA.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Montal” SHPK*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik*

II.8. Në datën 30.07.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, shtojca mbi modifikimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në zbatim të vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.9. Në datën 03.08.2021 operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e shtojcës mbi modifikimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.10. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr. 2071/4 prot., datë 10.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1437/2 prot., datë 13.08.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK duke konkluduar në mospranimin e saj.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK për ndryshimin e shtojcës mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke kërkuar ose rikthimin e specifikimeve teknike për këndin tilt të mikroskopit operator ORL, në diapazonin që ishte përcaktuar fillimisht në dokumentet e tenderit, ose zvogëlimin e këtij diapazoni, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10, “Specifikime teknike”, (Loti 12) të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor kishte përcaktuar, si më poshtë vijon:

#### **“Loti 12: Mikroskopë**

##### **Garancia**

*Deklarate per permbushjen e afatit te garancise: 3 vite nga marrja në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor. (Bazuar në eksperiencën e F.V. të pajisjeve mjekësore te PAI Polivalent, duke qene se eshte e njejta natyre pajisjesh mjekesore)*

##### **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

*Afatet e ekzekutimit: Furnizimi dhe vendosja e Pajisjeve Mjekësore (Për lotet nga Loti 5 deri në Lotin 29) në Godinën e Re të Pediatriisë në QSU “Nënë Tereza”, sipas të gjitha Specifikimeve të mësipërme do të kryhet maksimumi për 45 ditë kalendarike, nga lidhja e kontratës.*

***Afati i kohezgjatjes se Mareveshjes Kuader eshte 12 muaj.***

##### **1. Lloji i Pajisjes: Mikroskop operator okulistik**

*Të përgjithshme:*

*Mikroskopi operativ kirurgjikal*

*Përshkrimi i funksionit: Mikroskopët operativë oftalmikë përdoren për të zmadhuar anatomicën e syve për të ndihmuar gjatë operacionit oftalmik. Eshtë një mikroskop tip stereoskopik binokular me ndriçim të integruar i pajisur me lehtësi për ndryshimin e zmadhimit pa prishur rreshtimet e tjera, dmth kur zmadhimi ndryshohet, imazhi mbetet në fokus.*

*Mikroskop i pershtatshem per okulistike*

*Te kete suspension per rrotullimin dhe animin*

*Te kete frena elektromagnetike*

*Me zmadhim te motorizuar te pakten 4X-23X*

*Te jete me optike apokromatike*

*Te jete me fokus te motorizuar nga +18mm deri ne – 32mm*

*Inklinimi i okularve te jete te pakten 200°*

*Distance interpupulare te jete e rrgullueshme nga 58-73mm*

Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (+5d deri ne -8d)  
 Te kete modul iluminimi koaksial  
 Te kete te perfshire filtrat blue UV, drite dite, drite e lehte  
 Te kete diafragme per te reduktuar diametrin e iluminimit  
 Te kete nje set dorezash me butona te programueshem  
 Te kete lente frontale apokromatike  $f=200\text{mm}$   
 Te kete platforme levizje X-Y se paku 58mm x 58mm  
 Te kete permiresues te refleksit te kuq  
 Te kete ekran per te treguar statusin e zmadhimit, fokusit, te platformes X-Y  
 Platforma mbajtese te jete me frena elektromagnetike  
 Te jete me 4 rrota dopio me frena antistatike  
 Te kete 2 krahe te rrotullueshem secili nga  $270^\circ$ , gjatesia jo me pak se 1300mm  
 Te kete krah te balancuar per peshen te ndihmuar nga sensori  
 Te kete amortizator hidraulik per vibrimet horizontale dhe vertikale  
 te kete ekran me prekje per kontrollin dhe vendosjen e parametrave  
 Te kete 2 burime drite LED me fuqi jo me pak se 50 W secila me intensitet te rregullueshem  
 Te kete pedal komandimi me te pakten 13 funksione te programueshme me leve komandimi. Te jete me mbrojtje ndaj ujit  
 Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet me inklinim  $150^\circ$  distance interpupulare 58-73mm  
 Te kete kamera CMOS Full HD  
 Te kete kompjuter mjekesor per regjistrimin e videos, administrimin e te dhenave te pacientit, transferimin e videove dhe figurave.  
 Te kete mundesi per ruajtjen e jo me pak se 1000 ore regjistrim  
 Te kompresoje videot ne MPEG 4 / AVC (H.264)  
 Te perpunojte imazhet ne formatin JPEG, BMP, TIFF  
 Te kete ekran jo me te vogel se 21" per paraqitjen e videove ne kohe reale gjithashtu dhe regjistrimet.  
 Te shoqeohe me te pakten aksesoret e meposhtem:

- Set kapucesh per dorezat – 2 sete
- Set kapucesh per dorezat e asistentit – 2 sete
- Mbulesa pluhrash – 1 cope
- Kit pastim optik – 1 kit
- Te gjitha kabllot, aksesoret adaptoret e nevojshem per instalimin dhe lidhje e gjithe sistemit -1 set

## **2. Lloji i Pajisjes: Mikroskop operator ORL**

Mikroskop i pershtatshem per ORL  
 Te kete suspension per rrotullimin dhe animin  
 Te kete frena elektromagnetike  
 Me zoom te motorizuar te pakten 1.5x-14x  
**Rrotullim vertikal minimalisht  $530^\circ$ , inklinimi  $-25^\circ$  deri ne  $+115^\circ$ , tilt  $-35$  deri  $+35$**   
 Te jete me fokus te motorizuar nga 200mm deri ne 450mm  
 Me lente apokromatike



*Inklinimi i okularve te jete te pakten 200°*

*Distance interpupulare te jete e rregullueshme nga 58-73mm*

*Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (+5d deri ne -8d)*

*Te kete 2 doreza me butona te integruar te programueshe per funksionet e zmadhimit, fokus, nridicimit*

*Platforma mbajtese te jete me frena elektromagnetike*

*Te jete me 4 rrota dopio me frena antistatike*

*Te kete 2 krahe te rrotulueshem secili nga 270°, gjatesia jo me pak se 1300mm*

*Te kete krah te balancuar per peshen, te ndihmuar nga sensori*

*Te kete amortizator hidraulik per vibrimet horizontale dhe vertikale*

*Te kete ekran me prekje per kontrollin dhe vendosjen e parametrave*

*Te kete 2 burime drite LED fuqi jo me pak se 50 W secila me intensitet te rregullueshem*

*Te kete pedal komandimi me te pakten 13 funksione te programueshme, me leve komandimi. Te jete me mbrojtje ndaj ujit*

*Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet me inklinim 150° distance interpupulare 58-73mm*

*Te kete kamera CMOS Full HD*

*Te kete kompjuter mjekesor per regjistrimin e videos, administrimin e te dhenave te pacientit, transferimin e videove dhe figurave.*

*Te kete mundesi per ruajtjen e jo me pak se 1000 ore regjistrim*

*Te kompresoje videot ne MPEG 4 / AVC (H.264)*

*Te perpunoje imazhet ne formatin JPEG, BMP, TIFF*

*Te kete ekran jo me te vogel se 21” per paraqitjen e videove realtime, gjithashtu dhe regjistrimet.*

*Te shoqehet me te pakten aksesoret e meposhtem:*

- Mbulesa pluhrash – 1 cope
- Kit pastrimi optik – 1 kit

*Te gjithë kabllot, aksesoret adaptoret e nevojshem per instalimin dhe lidhje e gjithë sistemit -1 set”*

III.1.2. Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka ndryshuar specifikimet teknike për procedurën e prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

“[...]i- Specifikimet teknike, 26. Lloji i Pajisjes: Mikroskop operator okulistik, “Loti 12 Mikroskopë”.

**ISHTE:**

*Me zmadhim te motorizuar te pakten 4X-23X”.*

*Te jete me fokus te motorizuar nga +18mm deri ne – 32mm*

*Inklinimi i okularve te jete te pakten 200°*

*Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (+5d deri ne -8d)*

*Te kete te perfshire filtrat blue UV, drite dite, drite e lehte*

*Te kete platforme levizje X-Y se paku 58mm x 58mm*

*Te kete krah te balancuar per peshen te ndihmuar nga sensori*

*Te kete amortizator hidraulik per vibrimet horizontale dhe vertikale*

*Te kete 2 burime drite LED me fuqi jo me pak se 50 W secila me intensitet te rregullueshem  
Te kete pedal komandimi me te pakten 13 funksione te programueshme me leve komandimi. Te  
jete me mbrojtje ndaj ujit  
Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet  
me inklinim 150° distance interpupilare 58-73mm*

**BËHET:**

*Me zmadhim te motorizuar te pakten 4X-21X”.*

*Te jete me fokus te motorizuar nga +18mm deri ne – 32mm ose të jete me fokuste motorizuar  
prej te paktën 50mm me rikthim automatik.*

*Inklinimi i okularve te jete te pakten 180° .*

*Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (minimalisht +5d deri ne -5d)*

*Te kete te perfshire filtrat blue UV, drite dite, drite e lehte ose të filtër UV të integruara*

*Te kete platforme levizje X-Y se paku 50mm x 50mm me rikthim automatik*

*Te kete krah te balancuar per peshen.*

*Te kete burim kryesor drite LED, dhe burimi koaksial LED apo Halogjen 50W me intensitet te  
rregullueshem”*

*Te kete pedal komandimi me te pakten 12” funksione te programueshme me leve komandimi. Te  
jete me mbrojtje ndaj ujit”*

*Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet  
me inklinim minimumi 5°-25°, me distance interpupilare 58-73mm”*

*ii- Specifikimet teknike, 27, Lloji i Pajisjes: Mikroskop operator ORL, “Loti 12 Mikroskopë”.*

**ISHTE:**

*Me zoom te motorizuar te pakten 1.5x-14x*

**Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri ne +115°, tilt -35 deri +35**

*Te jete me fokus te motorizuar nga 200mm deri ne 450mm*

*Inklinimi i okularve te jete te pakten 200°*

*Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (+5d deri ne -8d)*

*Te kete krah te balancuar per peshen te ndihmuar nga sensori*

*Te kete 2 burime drite LED fuqi jo me pak se 50 W secila me intensitet te rregullueshem”*

*Te kete pedal komandimi me te pakten 13 funksione te programueshme me leve komandimi. Te  
jete me mbrojtje ndaj ujit*

*Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet  
me inklinim 150° distance interpupilare 58-73mm”*

**BËHET:**

*Me zoom te motorizuar te pakten 2x-14x.*

**Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri ne +95°, tilt -45 deri +45.**

*Te jete me fokus te motorizuar nga 225mm deri ne 450mm”*

*“Inklinimi i okularve te jete te pakten 120°”*

*Okularet te jene me kend te gjere 10X me rregullim te diopter (+5d deri ne -5d)”*

*Te kete krah te balancuar per peshen”*

*Te kete nje burim drite LED me fuqi jo me pak se 50 W dhe nje burim drite Xexon apo LED me  
fuqi jo me pak se 50 W, secila me intensitet te rregullueshem.*

*Te kete pedal komandimi me te pakten 12 funksione te programueshme me leve komandimi. Te jete me mbrojtje ndaj ujit”*

*Mikroskopi duhe te kete observues stereoskopik per asistentin me inklinim ne te 3 akset, okularet me inklinim 120° distance interpupilare 58-73mm” [...]”*

III.1.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen,*

*për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të

standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e

provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Konkretisht, KPP gjykon se edhe në përputhje me nenin 134 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se *”Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet*”. Kështu, në nenin 78 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.”* Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion*

*procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*". Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet ti përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, referuar nenit 27 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar (si akt në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit), specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

III.1.4. Lidhur me ndryshimin e specifikimit teknik për këndin tilt të mikroskopit operator ORL, i cili ankimohet nga operatori ekonomik "O.E.S Distrimed" SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ky ndryshim është kryer si pasojë e vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesës në kushtet e pranimit të pretendimeve të një tjetër operatori ekonomik ankimues. Komisioni i shqyrtimit të ankesës, ka pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Montal" SHPK, duke argumentuar: "[...]- Pretendimi i OE për specifikimin "*Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri në +115°, tilt -35 deri +35*", KSHA argumenton se prodhuesit e tjerë kryesor kanë kthimet e ngjashme të mjaftueshme për të realizuar ndërhyrjet e gjata me komoditet. Për të mundësuar ofrimin e sa më shumë produkteve cilësore në këtë garë, duke ruajtur të njëjtin funksionalitet dhe pamje optimale, kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet. Bëhet: *Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri në +95°, tilt -45 deri +45 [...]*"

Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "O.E.S Distrimed" SHPK, referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e argumentuar: "*Pas shqyrtimit të pretendimeve të Operatorit Ekonomik të paraqitura ne ankesen nr.2071 prot., datë 03.08.2021, Specialistet e fushes sipas kualifikimeve argumentojnë që: Një kënd më i madh i lëvizjes krahut krijon një mundësi më të madhe lëvizje të kokës, për të lejuar kirurgun të pozicionojë mikroskopin për të operuar dhe tek pacientë me kanale të jashtme dëgjimi të vështirë, kjo pasi ky mikroskop do të jetë i dedikuar për shërbimet mjekësore në Spitalin Pediatrik, ku kërkohet saktësi e ndërhyrjeve sa më delikate, në fizik me përmasa të vogla. Harku sa më i gjerë mundëson sukses. Nga verifikimi i prodhuesve të ndryshëm, konstatojmë se ka shumë prodhues ndërkombëtarë, europian etj., që plotësojnë të gjitha standartet e kërkuara në këtë procedurë prokurimi dhe që ofrojnë në produktet e tyre një hark minimalisht +/- 45 , e cila mundeson konkurrencë dhe pjesëmarrje më të gjerë të të gjithë operatorëve ekonomik*".

III.1.5. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se, për hartimin e specifikimeve teknike për pajisjen objekt-prokurimi, të cilat kundërshtohen nga operatori ekonomik ankimues "O.E.S Distrimed" SHPK, autoriteti kontraktor është bazuar në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 36 të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", duke vlerësuar si të

domosdoshme dhe të rëndësishme kapacitetet funksionale të pajisjes dhe performancën e saj. Në rastin konkret, bazuar në specifikat e veçanta të pajisjes objekt-prokurimi, si dhe bazuar në përdorimin kompleks të kësaj pajisjeje, Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor është tepër rëndësishme që të prokurojë pajisje që plotësojnë në mënyrë maksimale kapacitetet funksionale dhe që ofrojnë performancën më optimale, me qëllim trajtimin me rezultate sa më të mira të pacientëve. Në këto kushte, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të ndryshuara nga autoriteti kontraktor lidhur me këndin tilt të mikroskopit operator ORL, argumenteve të paraqitura nga autoriteti kontraktor, si dhe parashtrimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon se, specifikimi teknik “*Rrotullim vertikal minimalisht 530°, inklinimi -25° deri ne +95°, tilt -45 deri +45*”, është i justifikuar teknikisht nga autoriteti kontraktor, si dhe lidhet tërësisht me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes.

Akoma më tej, në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë konkrete që këto specifikime teknike çojnë drejt një prodhuesi të vetëm, apo kufizojnë në mënyrë të pajsutifikuar dhe të kundraligjshme konkurrencën. KPP rithekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së proves referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatori ekonomik ankimues duhet të kishte argumentuar/dëshmuar se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo se këto specifikime teknike nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë. Komisioni gjykon se, fakti që një ose disa prodhues nuk plotësojnë një apo disa specifikime teknike që lidhen ngushtësisht me funksionalitetin dhe performancën e pajisjes, nuk do të thotë që përbën automatikisht diskriminim ndaj këtyre prodhuesve.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



## **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-97586-06-07-2021 me objekt “*Loti 12 Mikroskopë*”, me fond limit 18,607,227 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**